



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 62/2019 (JR)

Tiranë, më 24.01.2022

Nr. 62/8 regj.

**SHPALLJE
E**

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se, më datë 24.01.2022, ora 10:00, trupi gjykues gjatë shqyrtimit, mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, të çështjes me numër regjistri (JR) 62/2019, datë 12.12.2019, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Dhurata Haveri, kundër vendimit nr. 197, datë 27.09.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 51, pika 1 germa “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me qëllim korrigjimin e shkeljeve procedurale të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me konstatimin e drejtë të situatës faktike, vendosi të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. V.V.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet më datë **08.02.2022, ora 10:00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykues	Sokol Çomo
Relatore e Çështjes	Albana Shtylla
Gjyqtar	Ardian Hajdari
Gjyqtare	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë përpara datës së seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR**

SOKOL ÇOMO

